

VENDIM
Nr. 66/2013

PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH “PËR NGRITJEN E NJË KOMISIONI HETIMOR PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHETËTËRORE TATIMORE, SI DHE PËR TË NJOHUR DHE VERIFIKUAR NË THELLËSI FENOMENIN E NDËRHRYJES DHE BLOKIMIT PËR DISA DITË TË SISTEMEVE ELEKTRONIKE TATIMORE”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shetëtorre tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”, për shkak se objekti i punës së këtij komisioni është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës, si dhe me interpretimet që Gjykata Kushtetuese ka bërë në vendimet e saj me nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 24.12.2013